



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:235003
Datë: 24.01.2025
Numri i dokumentit: 06751878

C. nr. 2252/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.H. nga fshati Reqan, Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson B.M. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës P.K. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, vlera e kontestit 3,353.2 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë: 24 janar 2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit S.H. nga fshati Reqan, Komuna e Suharekës.
- II. DETYROHET e paditura P.K. që paditësit, në emër të kompensimit të një page mujore (pagës së trembëdhjetë) t'ia paguaj shumën nga 571.90 euro (pesëqind e shtatëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë cent), për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në shumë të përgjithshme prej 1,715.7 euro (një mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë euro e 7 cent) e me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 18.10.2021 e deri në pagimin definitiv, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të "Obligohet" e paditura P.K. që në emër të kompensimit të ushqimit të në punë (shujtave) për vitet 2018, 2019 dhe 2020, të paguajë shumën prej 2.50 € për një ditë pune dhe atë për 655 ditë pune, e në shumën e përgjithshme prej 1,637.5 (një e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë euro e pesë cent) me kamatë ligjore prej 8 % nga momenti i paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare", si e pa bazuar.
- IV. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 144.00 euro, (njëqind e katër dhjet e katër euro), në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi pranë kësaj gjykate përmes të autorizuarit të tij av. B.M. më datë 18.10.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës P.K. të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e

Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e pagës së trembëdhjetë në shumë prej 571.90 euro për vitet 2018, 2019 dhe 2020, e në shumë prej 1,715.7 euro si dhe kompensimin të ushqimit të punës (shujtave) dhe atë për 655 ditë pune në shumë prej 2.50 euro për një ditë pune e në shumë prej 1,637.5 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej 3,353.2 euro, të gjitha me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në referatin e padisë ka theksuar që, paditësi S.H. është i punësuar me orare të plotë në Policinë e Kosovës, që nga data 21.09.2002, dhe vazhdon të punojë. Paditësi, si i punësuar në Policinë e Kosovës, duke u mbështetur në Ligjin e Punës nr.03/L-2012, nenet 55 dhe 59, Ligjin për Policinë e Kosovës, nenet 44 dhe 45, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.4/2017, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sipas nenit 29 par.2, (personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm), i takon të përfitojnë shpërblim jubilar një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt në fund të vitit. Paditësi e ka plotësuar këtë kusht, respektivisht ka treguar performacë shumë të mirë gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020. Ndërsa sipas par.1, të nenit 29, të Udhëzimit Administrativ Nr.4/2017, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, paditësit i takon e drejta në shujtë ditore, gjatë ditëve respektivisht orarit të punës. Në bazë të sistemit PRIMIS të lëshuar nga Policia e Kosovës dhe deklaratës personale të paditësit, paditësi gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020 ka realizuar gjithsejtë 655 dite pune, përkatësisht në vitin 2018 ka realizuar 216 ditë pune, në vitin 2019 ka realizuar 206 ditë pune dhe në vitin 2020 ka realizuar 233 ditë pune. Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 05.08.2021, i është drejtuar MPB/Policia e Kosovës/Drejtoria e Përgjithshme/ Drejtoria për Personel, me kërkesë për kompensimin e pagës së trembëdhjetë dhe kompensimit të ushqimit gjatë orarit të punës. Më datë 08.10.2021, kanë pranuar njoftimin me të cilën i është refuzuar kërkesa e paditësit me arsyetimin e të paditurës se nuk ka mjete financiare.

Ashtu nga gjykata ka kërkuar që ta obligoj të paditurën – P.K. që në emër të kompensimit të pagës së 13 për vitet 2018, 2019 dhe 2020, të ia paguaj shumën në lartësi prej 1,715.7 euro si dhe shujtat ditore në lartësi prej 1,637.5 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej 3,353.3 euro, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8% nga momenti i paraqitjes së padisë.

E paditura brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në padi, ku ka theksuar se nuk e konteston faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, po e mohon kërkesën dhe padinë e paditësit, pasi që paraprakisht nuk është bërë shterja e mjeteve juridike nga ana e paditësit në kuptim të nenit 78 paragrafi 1 dhe 2 të ligjit të punës. Ndërsa sa i përket specifikisht kërkesës për pagën e 13-të, e ka kundërshtuar pasi që kjo kërkesë nuk është realizuar për asnjë punonjës së Policisë së Kosovës për shkak të mjeteve financiare, po ashtu thekson se e paditura edhe pse ka kërkuar mjete financiare nga Ministria e Financave, e njëjta nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës, ashtu që në mungesë së mjeteve buxhetore nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Kërkesëpadija e paditësit për pagesën e shujtave e kundërshtoj me arsyetimin se nuk ka bazë ligjore sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme r. protokollit 213/2023 datës 09.10.2023. Po ashtu thekson se kompensimi i pagës 13 –të, shujtave e kundërshtojnë pasi që kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, mbi këto baza i propozojnë gjykatës që padinë ta hedhë poshtë si e pa lejuar, apo që eventualisht gjykata ta refuzoj si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Nga gjithë të thënat ka theksuar se padia

nuk ka bazë ligjore ngase e paditura vlerëson se ka përmbushur detyrimet ligjore nga marrëdhënia e punës e paraparë me kontratën e punës dhe ligjin për policinë e Kosovës. Kërkesë padia e mbështetur në UA 02/2018, nuk paraqet detyrim për deri sa e paditura ka përmbushur obligimet ligjore. Andaj, i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj si të pa themeltë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi që nga viti 2002 është në marrëdhënie pune te e paditura.

Gjykata përmes vërtetimit të punësimit me numër të referencës 04/1-04-SRR-A/168/2021, të datës 31.03.2021, vërtetoi faktin se paditësi për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 571.90 euro në muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendarik 2018, 2019 dhe 2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi për vitin 2018, ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4, që korrespondon me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm, vitin 2019 ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4, që korrespondon me vlerësimin i kënaqshëm dhe për vitin 2020 ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4, që korrespondon me vlerësimin i kënaqshëm.

Vërtetimin si dhe formularët e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj vërtetimit me të cilin është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe formularëve me të cilin është bërë vlerësimi i punës së paditësit për vitet kalendarike 2018,2019 dhe 2020, Gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*. Në nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*. Ndërsa neni 55 par.1 nënpar.1.7 i këtij Ligji përcakton se: *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*. Në nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*, ndërsa në pikën 2 të këtij paragrafi parashihet *“Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”*. Ndërkaq në nenin 29 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda*

vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13 për çdo fund vit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi ka qenë për vitin 2018, 2019 dhe 2020, kanë qenë plotësisht të kënaqshme, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese si në dispozitivin nën I dhe II të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit për këtë pjesë është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kërkesën e palës që në emër të kompensimit të ushqimit të në punë (shujtave) të paguajë shumën prej 2.50 € për një ditë pune dhe atë për 655 ditë pune, e në shumën e përgjithshme prej 1,637.5 euro, vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.*

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e shujtave ditore dhe atë për periudhën 2018 deri 2020 pasi që paditësi nuk ka arritur që të provoj se këtu me të paditurën si punëdhënëse ka raport kontraktual ku është përcaktuar detyrimi i të paditurës për paditësin për kompensimin e shujtave ditore.

Pretendimi i paditësit, se në neni 29 par.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës përcakton detyrimin mbi ushqimin gjatë ditëve të punës gjykata e gjeti si të pa bazuar, pasi që në neni 29 par.1 të këtij udhëzimi parashihet që *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”* pra kjo dispozitë përcakton kushtet të përgjithshme të cilave palët kontraktuese, duhet të ju përmbahen lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, ku kriter për vendosur mbi këto të drejta duhet të jetë vendi i punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici, por si dispozitë nuk përcakton në vetvete detyrimin për kompensim, e në këtë çështje

kontestimore kompensimin për shujta ditore. Gjykata në kuptim të nenit 47 par 4 të ligjit për policinë (LIGJI Nr. 04/L-076) ku përcaktohet se “*Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore*” vlerëson se për të ju njohur e drejta për kompensim në shujta duhet të përcaktohet shprehimisht në Ligj apo në aktet e brendshme nënligjore (që në rastin konkret nuk është përcaktuar shprehimisht me aktet nënligjore të të paditurës se personelit policor i takon e drejta e kompensimit në shujta ditore).

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritör.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë kërkesës tek e paditura (18.10.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur nga pranimi i kërkesës të datës 20.08.2021, është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 par.3 dhe nenit 463 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit i referohen shumës së precizuar si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimit e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga pala paditëse dhe atë: për përpilimin e padisë në shumën prej 104 euro, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 40 euro, e në shumë të përgjithshme prej 144.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.2252/21 më datë: 24 janar 2025

B.profesional
Ilir Sërrollaj

Gjyqtari
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.